REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË**

**P/VENDIM**

Nr 3561 Prot B.Curri, me 05. 08. 2025.

Nr_____ datë _______2025

**Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Tropojë**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"I ndryshuar , Ligji Nr. 9936/ 2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 68/ 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji Nr. 9632/ 2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Kwshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planin të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Tropojë, 2026-2028 bashkëngjitur këtij dokumenti.
2. Për zbatimin e këtij vendimi t ngarkohet Sektorit Arsimit dhe Kulturës
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë nga data e shpalljes

**Sh . Gjoka**
**S.Isaku**
**Juristi** I.ISMAILI SUFAJ
**Sekretari**
**E.Gjongecaj**

**KRYETARI BASHKISË**

**Rexh BYBERI**

**Me urdher dhe porosi**

**Zv.Kryetare**

**Zyra Islamaj**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" email: info@tropoje.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË

Nr 3561/1 Prot B.Curri, me 05. 08. 2025.

# RELACION

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Tropojë**

## PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË BASHKISË TROPOJË 2026–2028

### I. Hyrje

Arsimi është një shtyllë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale dhe shoqërisë në tërësi. Bashkia Tropojë, duke njohur rëndësinë e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor, ka hartuar Planin e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për periudhën 2026–2028. Ky plan synon të garantojë akses të barabartë në arsim, të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies, dhe të mbështesë zhvillimin profesional të stafit arsimor si dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore.

### II. Qëllimi i Planit

Qëllimi i këtij Plani është ndërtimi i një sistemi arsimor vendor që promovon përfshirjen, cilësinë dhe qëndrueshmërinë. Plani është konceptuar për të adresuar sfidat aktuale dhe për të ndërtuar një vizion afatgjatë të zhvillimit të arsimit parauniversitar në Bashkinë Tropojë.

### III. Objektivat Strategjikë

1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies në të gjitha ciklet arsimore.

2. Zgjerimi i aksesit në arsim për të gjithë fëmijët, veçanërisht për grupet në nevojë.

3. Modernizimi i infrastrukturës shkollore dhe pajisja me logjistikë bashkëkohore.

4. Zhvillimi profesional i mësuesve dhe përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore.

5. Forcimi i bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin.

## IV. Baza Ligjore

Plani mbështetet në kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar dhe vendor, përfshirë:

- Ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

- Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021–2026.

- Dokumentet planifikuese të Bashkisë Tropojë.

## V. Rëndësia e Planit për Bashkinë dhe Komunitetin

Ky plan paraqet një vizion të qartë për zhvillimin e arsimit në Tropojë, duke adresuar sfida për përmirësimin e cilësisë mësimdhënies përmirësimin e infrastrukturës, si dhe nevoja për përfshirje të komuniteteve. Ai përbën një mjet thelbësor për ndërtimin e një brezi të edukuar dhe të përgatitur për të ardhmen.

## VI. Prioritetet e Planit

1. Rikonstruksion i objekteve shkollore dhe përmirësim i kushteve sanitare.

2 Nisma për përfshirje sociale dhe parandalimin e braktisjes shkollore.

3. Investim në teknologji dhe digjitalizim.

4. Trajnime për mësuesit dhe drejtuesit shkollorë.

5. Bashkëpunim me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

## VII. Aktivitetet Kryesore

- Hartimi i një baze të dhënash të përditësuar.

- Trajnime për staf pedagogjik.

- Programe për përfshirjen e prindërve.

- Mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta.

- Aktivizimi i klubeve të nxënësve.

## VIII. Ngritja e Kapaciteteve

Plani përfshin zhvillim profesional për stafin arsimor, ngritjen e strukturave bashkiake për monitorim dhe forcimin e bashkëpunimit institucional.

## IX. Monitorimi dhe Vlerësimi

Plani do të shoqërohet me një sistem monitorimi me indikatorë si rezultatet mësimore, pjesëmarrja në arsim, përfshirja sociale dhe efiçenca e përdorimit të burimeve.

## X. Përfundime

Ky plan është një dokument strategjik thelbësor për ndërtimin e një sistemi arsimor të fortë dhe gjithëpërfshirës në Bashkinë Tropojë. Miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak do të shënojë një hap vendimtar drejt një të ardhme më të ndritur për brezin e ri dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

**Pregatiti :**

**Sh.Gjoka**

**S.Isaku**

Nr 3561/2 Dt 05.08.2025

2026-
2028





BASHKIA TROPOJË

# PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028


**Grupi punes :**
**Shkurta Gjoka**
**Suzana Isaku**

**Miratoi :Kryetari Bashkise**
**Rexhe Byberi**
**Ne mungese dhe me Urdher**
**Zv.Kryetare**
**Zyra Islamaj**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA TROPOJE

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" email: info@tropoje.gov.al

# Parathënie :

Arsimi parauniversitar përbën bazën themelore të zhvillimit arsimor dhe shoqëror te cdo individi. Ai perfshin ciklet me te rendesishme te edukimit: nga arsimi parashkollor deri ne perfundimin e shkolles se mesme ku vendosen themelet per njohurite,aftesite dhe vlerat qe udheheqin individin gjate gjithe jetes. Ne kete plan project analizohen aspektet kyce te arsimit parauniversitar ne tropoje,reformat e nderrmarra dhe roli I shkolles ne rritjen e cilesise se sherbimit arsimor ne bashkine tone. Bashkia Tropoje ka percaktuar nje vision te qarte dhe te arritshem:"Te ndertojme nje sistem arsimor gjitheperfshires,cilesor dhe te aksesueshem per cdo femije ne territorin e bashkise tropoje,ku cdo instutucion edukativ te jete nje hapesire e sigurt,e pajisur,e perkushtuar dhe e lidhur ngushte me komunitetin". Realizimi i ketij vizioni mbeshtet ne keto shtylla:

1) Perfshirje dhe barazi
2) Cilesi dhe zhvillim profesional
3) Infrastrukture dhe mjedis edukues
4) Zhvillim i hershem dhe kujdes parashkollor
5) Bashkepunimi me prinderit dhe komunitetin

Plani per zhvillimin e arsimit parauniversitar eshte nje reflektim mbi realitetin e arsimit ne Tropoje. Ai permban prioritetet tona:

**a)** Sigurimin e nje mjedisi te sigurt dhe te pershtateshem

**b)** Rritjen e cilesise se edukimit dhe fuqizim e lidhjes se shkolles me familjen dhe komunitetin.

Synimi themelor I realizimit te ketij prjekti eshte: Cdo femije te kete akses te plote ne nje arsim te denje,cilesor dhe gjitheperfshires.

## Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje ..........
2. Të dhëna të përgjithshme ..........
Konteksti administrativ ..........
Të dhëna demografike ..........
Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve ..........
Frekuentimi ..........
Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit shkollave dhe konvikteve të arsimit parauniversitar ..........
Frekuentimi në arsimin fillor ..........
Frekuentimi arsimi 9-vjecar ..........11
Frekuentimi arsimi i mesem ..........
Profili i njësive administrative ..........
Njësia Administrative: Bajram Curri ..........
Njësia Administrative: Tropoje ..........
Njësia Administrative: Margegaj ..........
Njësia Administrative: Bujan ..........
Njësia Administrative: Fierze ..........
Njësia Administrative: Llugaj ..........
Njësia Administrative: Bytyc ..........
Njësia Administrative: Lekbibaj ..........
3. Plani 2026 -2028 ..........
Hyrje ..........
Buxheti i Planifikuar për Arsimin (2025–2028) ..........
Arsimi Parashkollor ..........
Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm ..........
Prioritetet dhe objektivat ..........
Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore ..........

Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve arsimore cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale. ........................................................

Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare tek femijet....................................................

4. Plani i investimeve..........................................................................................................

Ndërtimi i shkollave të reja për përmirësimin e infrastrukturës arsimore. .................................

5. Monitorimi i planit..........................................................................................................

Monitorimi sipas objektivave ..............................................................................................

Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore ..................................

Monitorimi i aktiviteteve ..................................................................................................

Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale. ........................................................

Monitorimi i aktiviteteve ..................................................................................................

Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare. .....................................................................

Monitorimi i aktiviteteve ..................................................................................................

1. Hyrje

**Ky plan përfaqëson një analizë të detajuar të situatës së shërbimit të arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë Tropoje për periudhën 2024–2025.**
Analiza është hartuar me qëllim të mbështetjes së proceseve të planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes në fushën e arsimit, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi burimet ekzistuese, sfidat aktuale dhe mundësitë për përmirësim ne fushen e arsimit.

**Qëllimi kryesor i këtij plani është të shërbejë si bazë për hartimin e politikave arsimore afatmesme për periudhën 2026–2028,** duke u fokusuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në përputhje me nevojat lokale të popullsisë, tendencat demografike, shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore dhe burimet njerëzore dhe infrastrukturore në dispozicion.

Plani synon gjithashtu të identifikojë boshllëqet në aksesin, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve arsimore me qëllim që të krijohen kushte të barabarta arsimimi dhe edukimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Tropoje.

## 2. Të dhëna të përgjithshme

### Konteksti administrativ

Bashkia Tropojë përfshin një numër njësish administrative, ku secila prej tyre luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.
Kjo strukturë e përbërë nga 8 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale dhe ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Diversiteti gjeografik dhe demografik mes njësive administrative te Bashkisë Tropojë kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin dhe zhvillimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Tropojë përfshin 8 njësi administrative:

- Bajram Curri
- Tropojë
- Margegaj
- Bujan
- Fierzë
- Llugaj
- Bytyc
- Lekbibaj

të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arasimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

### Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Tropojë është 28,224 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 14,530 meshkuj dhe 13,701 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.




Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm.

## Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve

Në Bashkinë Tropoje shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Tropeje funksionojnë 24 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.




Në territorin e Bashkisë Tropojë janë të shpërndara gjithsej 35 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar.

## Frekuentimi

Në bashkinë Tropojë, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 628, prej të cilët 322 janë djem dhe 306 janë vajza. Nga kjo popullsi, 458 fëmijë ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 247 djem dhe 211 vajza.

Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 73.2% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor. Megjithatë, 170 fëmijësh ende nuk ndjekin kopshtin nga të cilët 92 anë djem dhe 78 janë vajza, duke treguar një boshllëk i cili vjen si pasojë e migrimit dhe emigrimit të popullsisë.

Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 73% e fëmijëve e ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 51.79% e djemve dhe 48.20% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Tropoje.

## Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit shkollave dhe konvikteve të arsimit parauniversitar

Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (7 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (22 gjithsej) dhe shkolla të mesme (7 gjithsej).

**Shkollat fillore** u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.

**Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 22 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.

**Shkollat e mesme**, në numër prej 7, që përfshijnë gjimnazet, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.




Ne territorin e Bashkise Tropoje jane te shperndara gjithsej 35 institucione arsimore te niveleve te ndryshme, te cilat mbulojne te gjitha njesite administrative urbane dhe rurale te bashkise. Keto institucione perfaqesojne nje rrjet te gjere dhe te larmishem te arsimit parauniversitar.

## Frekuentimi në arsimin fillor

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 812 nga të cilët 422 janë djem dhe 390 vajza. Sipas te dhenave te raportuara 51.9% jane djem dhe 48.1% jane vajza. Kjo ndarje reflekton situaten e perfshirjes ne kete nivel arsimor e cila ndryshon sipas njesive ne varesi te kushteve lokale, demografise dhe mundesive te ofruara per arsimim nga komuniteti. Keto te dhena nenvizojne rendesine e vazhdimit te perpjekjeve per te garantuar akses te barabarte dhe gjithperfshires ne arsimin fillor per te gjithe femijet pavaresisht vendbanimit apo gjendjes se tyre social-ekonomike. Sigurimi i kushteve te pershtateshme per ndjekjen e shkolles dhe mbeshtetjen instutucionale mbeten faktor kyc per permiresimin e metejshem te perfshirjes.

## Frekuentimi arsimi 9-vjecar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 707 nxënës, prej të cilëve 375 janë djem dhe 332 vajza. Sipas të dhënave, 53.04% e nxënësve janë djem dhe 46.96% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

## Frekuentimi arsimi i mesem

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 423 nxënës, nga të cilët 232 janë djem dhe 191 vajza, përkatësisht 54.8% djem dhe 45.2% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Njësia Administrative: Bajram Curri

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 4 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 0 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 3 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 eshte shkolle e mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes sistemit te shkollave njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri I Shkolles | Numri i nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla 9-vjecare "Konferenca e Bujanit" | 95 | 48 | 47 |
| Shkolla 9-vjecare "Beselidhja e Malesise" | 227 | 129 | 98 |
| Shkolla 9-vjecare "Ali Podrimja" | 379 | 203 | 176 |
| Gjimnazi "Asim Vokshi" | 256 | 129 | 127 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i Kopshteve | Numri i Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti "Rreze Drite" | 90 | 46 | 44 |
| Kopshti "Fatime Sokoli" | 100 | 55 | 45 |
| Kopshti prane shkolles "Konferenca e Bujanit" | 15 | 8 | 7 |
| Kopshti prane "Beselidhja e Malesise" | 18 | 10 | 8 |
| Kopshti prane shkolles "Ali Podrimja" | 27 | 13 | 14 |

Njësia Administrative: Tropoje

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 9 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 2 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 6 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 eshte shkollë e mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkollave | Numri i Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolle e Mesme e Bashkuar "Ali Iber Neza" | 164 | 89 | 75 |
| Shkolla 9-vjecare Babine | 27 | 11 | 16 |
| Shkolla 9-vjecare Begaj | 7 | 3 | 4 |
| Shkolla 9-vjecare "Xheladin Gosturani" | 24 | 15 | 9 |
| Shkolla 9-vjecare "Hysni Zajmi" | 3 | 2 | 1 |
| Shkolla Fillore Myhejan | 8 | 2 | 6 |
| Shkolla 9-vjecare "Lugi i Zi" (vartese) | 10 | 6 | 4 |
| Shkolla 9-vjecare Bucaj | 33 | 17 | 16 |
| Shkolla 9-vjecare "Rrustem Sulejmani" | 5 | 3 | 2 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 6 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri I Kopshtit | Numri I femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti Babine | 10 | 6 | 4 |
| Kopshti Sopot | 12 | 5 | 7 |
| Kopshti Shumice | 8 | 4 | 4 |
| Kopshti "Xheladin Gosturani" | 7 | 5 | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kopshti “Hysni Zajmi” | 5 | 3 | 2 |
| Kopshti Aste | 33 | 17 | 16 |

Njësia Administrative: Margegaj

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 4 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 0 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 4 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 0 janë shkolla të mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë ofrimin e sherbimit arsimor per te gjithë fëmijët e kesaj njesie administrative si ne vendbanimet qendrore dhe ato rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri I Shkollave | Numri I Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla 9-vjecare "Musha Kadria" | 43 | 16 | 27 |
| Shkolla 9-vjecare "Haxhi Zeke Byberi" | 8 | 3 | 5 |
| Shkolla 9-vjecare "Dragobi" | 9 | 3 | 6 |
| Shkolla 9-vjecare "Valbone" | 22 | 8 | 14 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë ndodhen gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri I Kopshteve | Numri I Femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti Valbone | 10 | 6 | 4 |
| Kopshti Shoshan | 2 | 1 | 1 |
| Kopshti Margegaj | 12 | 6 | 6 |

Njësia Administrative: Bujan

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 3 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolle eshte në ciklin fillor, ndërsa 2 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.




Lista e shkollave përfshin:

| Emri I Shkollave | Numri I Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla 9-vjecare "Jaho Salihi" | 82 | 44 | 38 |
| Shkolla 9-vjecare Geghysen | 22 | 6 | 16 |
| Shkolla Fillore Gri | 5 | 4 | 1 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri I Kopshteve | Numri I Femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti “Sherif Nuha” | 8 | 6 | 2 |
| Kopshti “Jaho Salihi” | 11 | 4 | 7 |
| Kopshti Gri | 5 | 4 | 1 |

Njësia Administrative: Fierze

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 3 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolle eshte në ciklin fillor, 1 shkolle 9-vjeçare që ofron ciklin bazë të arsimit dhe 1 gjimnaz.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri I Shkollave | Numri I Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla 9-vjecare "Mato Shuka" | 101 | 551 | 50 |
| Shkolla 9-vjecare "Azem Hajdari" (vartese) | 22 | 13 | 9 |
| Shkolla Fillore "Niman Syla" | 3 | 1 | 5 |
| Gjimnazi "Mato Shuka" | 41 | 21 | 20 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 2 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri I Kopshteve | Numri I Femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti "Mato Shuka" | 14 | 9 | 5 |
| Kopshti "Niman Syla" | 6 | 3 | 3 |

Njësia Administrative: Llugaj

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 3 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolle eshte në ciklin fillor, 1 shkolle 9-vjeçare që ofron ciklin bazë të arsimit dhe 1 gjimnaz.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.




Lista e shkollave përfshin:

| Emri I Shkollave | Numri I Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla 9-vjecare "Leke Qokaj" | 82 | 44 | 38 |
| Shkolla e Mesme e Bashkuar "Oso Dauti" | 32 | 25 | 7 |
| Shkolla Fillore Luzhe | 1 | 1 | 0 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë eshte hapur gjithsej 1 kopesht i vendosur në zone të pershtateshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Ky institucion luan një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri I Kopshtit | Numri I Femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti Llugaj | 11 | 4 | 7 |

Njësia Administrative: Bytyc

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 4 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolle eshte në ciklin fillor, 1 shkolle 9-vjeçare që ofron ciklin bazë të arsimit dhe 2 te mesme te bashkuara.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkollave | Numri i Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla e Mesme e Bashkuar “Hoxhe Zogu” | 63 | 31 | 32 |
| Shkolla e Mesme e Bashkuar “Murat Paci” | 14 | 9 | 5 |
| Shkolla 9-vjecare Berishe | 10 | 6 | 4 |
| Shkolla Fillore Prush | 11 | 5 | 6 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë jane hapur gjithsej 2 kopshte te vendosur në zona të pershtateshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopsheve përfshin:

| Emri i Kopshteve | Numri i Femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti “Murat Paci” | 14 | 7 | 7 |
| Kopshti Prush | 10 | 5 | 5 |

Njësia Administrative: Lekbibaj

*Shkollat*

Në total, funksionojnë 5 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolle eshte në ciklin fillor, 3 shkolla 9-vjeçare që ofron ciklin bazë të arsimit dhe 1 gjimaz.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri I Shkollave | Numri I Nxenesve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Shkolla e Mesme e Bashkuar "Tinka Kurti" | 40 | 22 | 18 |
| Shkolla 9-vjecare "Gjon Pepaj" | 8 | 3 | 5 |
| Shkolla Fillore "Mserr" | 9 | 2 | 7 |
| Shkolla 9-vjecare "Palc" | 1 | 0 | 1 |
| Shkolla 9-vjecare "Salse" | 1 | 0 | 1 |

*Kopshtet*

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë eshte hapur gjithsej 1 i vendosur në zone të pershtateshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Ky instutucion luan një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopsheve përfshin:

| Emri I Kopshteve | Numri I Femijeve | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Kopshti "Tinka Kurti" | 5 | 2 | 3 |

3. Plani 2026 -2028

Hyrje

Plani i Arsimit 2026–2028 përfaqëson një strategji afatmesme që synon përmirësimin e cilësisë, aksesit dhe barazisë në sistemin arsimor. Ai është hartuar në përputhje me prioritetet kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe me nevojat e identifikuara në nivel vendor, me qëllim ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, të orientuar drejt nxënësit dhe të përshtatur me kërkesat e shekullit XXI.

Ky plan fokusohet në disa shtylla kryesore:

- **Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit**, përmes trajnimeve të vazhdueshme për mësuesit, përditësimit të kurrikulave dhe nxitjes së metodave bashkëkohore pedagogjike.
- **Zgjerimi i aksesit në arsim**, veçanërisht për fëmijët nga grupet e margjinalizuara dhe në zonat rurale.
- **Modernizimi i infrastrukturës shkollore**, duke përfshirë pajisjen me mjete teknologjike, përmirësimin e kushteve fizike dhe dixhitalizimin e proceseve arsimore.
- **Forcimi i menaxhimit dhe qeverisjes në arsim**, me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.
- **Nxitja e përfshirjes së komunitetit dhe partnerëve lokalë**, si një faktor kyç për garantimin e vijimësisë në arsim dhe suksesit të politikave të zbatuara.

Plani parashikon objektiva të matshme për çdo vit, burime të përcaktuara dhe një mekanizëm të monitorimit dhe vlerësimit të progresit, duke siguruar një qasje të qëndrueshme dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete në përmirësimin e sistemit arsimor.

## Buxheti i Planifikuar për Arsimin (2025–2028)

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.
Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave.
- Funksionimin e Qendrës kulturore të fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë paragat e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore. Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar ngarkesën buxhetore të bashkisë, mënyrën e përdorimit të fondeve publike për arsimin, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit

Shërbimi i arsimit parashkollor financohet nëpërmjet dy burimeve kryesore të të ardhurave: të ardhurat vendore nga taksat dhe tarifat, si dhe transferimet nga qeveria qendrore.

- **Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore** për arsimin parauniversitar përbëjnë një komponent të rëndësishëm të buxhetit, duke reflektuar angazhimin e bashkisë për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare për shërbimet vendore që ka kompetencë.
- **Transferimet e pakushtëzuaara sektoriale nga qeveria qendrore** mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin e institucioneve arsimore, duke përfshirë pagat e stafit dhe shpenzimet operative.

### Arsimi Parashkollor

Në kuadër të përmirësimit të arsimit parashkollor, janë planifikuar investime të fokusuara në rikonstruksionin dhe zgjerimin e çerdheve dhe kopshteve ekzistuese, ndërtimin e objekteve të reja në zonat me mungesë kapacitetesh, përmirësimin e pajisjeve didaktike dhe garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Gjithashtu, një pjesë e fondit do të shërbejë për trajnimin e stafit edukues dhe përfshirjen më të gjerë të komunitetit prindëror në jetën institucionale të këtyre strukturave.

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parashkollor është si me poshte mijë lekë, të shpërndara si më poshtë:

(Te dhenat jane ne mije Leke)

#### *Viti 2025*

Totali i planifikuar **për vitin 2025** është **81,704** Leke i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **78,040 Leke**
- Shpenzime korrente **3,664 Leke**
- Shpenzime kapitale **10,000 Leke**

#### *Viti 2026*

Totali i planifikuar **për vitin 2026** është **81,704** Leke i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **78,040 Leke**
- Shpenzime korrente **3,664 Leke**
- Shpenzime kapitale **15,000 Leke**

#### *Viti 2027*

Totali i planifikuar **për vitin 2027** është **81,704** Leke i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **78,040 Leke**
- Shpenzime korrente **3,664 Leke**
- Shpenzime kapitalem **6,000 Leke**

### *Viti 2028*

Totali i planifikuar **për vitin 2028** është **81,704** Leke i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **78,040 Leke**
- Shpenzime korrente **3,664 Leke**
- Shpenzime kapitalem **6,000 Leke**

Shpenzimet parashikohen të kontribuojnë në forcimin e një sistemi parashkollor gjithëpërfshirës, të aksesueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë.

## Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm, investimet synojnë modernizimin e infrastrukturës arsimore, pajisjen me mjete didaktike dhe teknologjike, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit mësimor dhe drejtuesve shkollorë. Këto ndërhyrje kanë si qëllim krijimin e kushteve të barabarta mësimore për të gjithë nxënësit dhe përmirësimin e performancës akademike në të gjithë territorin e bashkisë.

Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për këtë sektor për **vitet 2025–2028** arrin në mijë lekë **,** të shpërndara si më poshtë:

### *Viti 2025*

Totali i planifikuar **për vitin 2025** është **6 , 0 7 9 Leke** ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **4.526 Leke**
- Shpenzime korrente **1,554 Leke**
- Shpenzime kapitale **2 1 , 4 8 3 Leke**

### *Viti 2026*

Totali i planifikuar **për vitin 2026** është **6,079** Leke ,i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore**) 4,526 Leke**
- Shpenzime korrente **1,554 Leke**
- Shpenzime kapitale **15,000 Leke**

### *Viti 2027*

Totali i planifikuar **për vitin 2027** është **6,079** Leke, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **4,526 Leke**
- Shpenzime korrente **1,554 Leke**
- Shpenzime kapitale **8,000 Leke**

### *Viti 2028*

Totali i planifikuar **për vitin 2028** është **6,079** Leke, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime personeli (Paga & Sigurime Shoqerore) **4,526 Leke**
- Shpenzime korrente **1,554 Leke**
- Shpenzime kapitale **7,000 Leke**

Këto fonde janë të orientuara drejt ndërtimit të një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke kontribuar njëkohësisht në reduktimin e braktisjes shkollore dhe forcimin e lidhjes midis arsimit dhe zhvillimit lokal.

### Prioritetet dhe objektivat

| Nr | Objektivi |
|---|---|
| 1 | Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore |
| 2 | Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale. |
| 3 | Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare. |

### Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore

**Pershkrimi:**

Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore

**Lista e aktiviteteve:**

| Nr | Periudha | Titulli i veprimtarise | Vitet |
|---|---|---|---|
| 1 | Brenda vitit | Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore | 2026,2027,2028 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Brenda vitit | Garantimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve higjeno-sanitare | 2026,2027,2028 |
| 3 | Brenda vitit | Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 4 | Brenda vitit | Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 5 | Brenda vitit | Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit | 2026,2027,2028 |
| 6 | Brenda vitit | Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 7 | Brenda vitit | Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 8 | Brenda vitit | Furnizimi dhe shërbimi ushqimor për mensat në institucionet e arsimit parashkollor | 2026,2027,2028 |

Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale.

**Pershkrimi:**

Të garantohet mirërritja, edukimi dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve në kopshte, shkolla, konvikte dhe qendra kulturore, përmes ofrimit të një shërbimi cilësor edukues për fëmijët, si dhe përmes forcimit të shërbimeve të integrimit dhe të përkujdesjes sociale.

**Lista e aktiviteteve:**

| **Nr** | **Periudha** | **Titulli i veprimtarise** | **Vitet** |
|---|---|---|---|
| 1 | Brenda vitit | Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë | 2026,2027,2028 |
| 2 | Brenda vitit | Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera | 2026,2027,2028 |
| 3 | Brenda vitit | Mbështetja e punonjësve të institucioneve arsimore për zhvillimin profesional dhe zhvillimin e kurrikulës | 2026,2027,2028 |
| 4 | Brenda vitit | Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat. | 2026,2027,2028 |

Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare.

| Nr | Periudha | Titulli i veprimtarise | Vitet |
|---|---|---|---|
| 1 | Brenda vitit | Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore | 2026,2027,2028 |
| 2 | Brenda vitit | Garantimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve higjeno-sanitare | 2026,2027,2028 |
| 3 | Brenda vitit | Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 4 | Brenda Vitit | Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 5 | Brenda vitit | Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit | 2026,2027,2028 |
| 6 | Brenda vitit | Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 7 | Brenda vitit | Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore | 2026,2027,2028 |
| 8 | Brenda vitit | Furnizimi dhe shërbimi ushqimor për mensat në institucionet e arsimit parashkollor | 2026,2027,2028 |

Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale.

**Pershkrimi:**

Të garantohet mirërritja, edukimi dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve në kopshte, shkolla, konvikte dhe qendra kulturore, përmes ofrimit të një shërbimi cilësor edukues për fëmijët, si dhe përmes forcimit të shërbimeve të integrimit dhe të përkujdesjes sociale.

**Lista e aktiviteteve:**

| Nr | Periudha | Titulli i veprimtarise | Vitet |
|---|---|---|---|
| 1 | Brenda vitit | Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë | 2026,2027,2028 |
| 2 | Brenda vitit | Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera | 2026,2027,2028 |
| 3 | Brenda vitit | Mbështetja e punonjësve të institucioneve arsimore për zhvillimin profesional dhe zhvillimin e kurrikulës | 2026,2027,2028 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Brenda vitit | Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat. | 2026,2027,2028 |

Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare.

**Pershkrimi:**

Ky objektiv synon të ofrojë mundësi të larmishme jashtë kurrikulës mësimore për fëmijët, duke nxitur zhvillimin personal, sjelljet e shëndetshme, krijimtarinë, përfshirjen sociale dhe formimin e tyre në frymën e vlerave qytetare dhe universale.

**Lista e aktiviteteve:**

| Nr | Periudha | Titulli i veprimtarise | Vitet |
|---|---|---|---|
| 1 | 20-27 shtator | Java Evropiane e Sportit | 2026,2027,2028 |
| 2 | Prill-Maj | Java Olimpike | 2026,2027,2028 |
| 3 | 20 nëntor | Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve | 2026,2027,2028 |
| 4 | 21 nëntor | Dita e Luftës Kundër Bullizmit | 2026,2027,2028 |
| 5 | Brenda vitit | Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe | 2026,2027,2028 |
| 6 | 3 dhjetor | Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara | 2026,2027,2028 |
| 7 | 22 Mars | Dita Botërore e Ujit (UNESCO) | 2026,2027,2028 |
| 8 | 23 prill | Dita Botërore e Librit | 2026,2027,2028 |
| 9 | 5 qershor | Dita Botërore e Mjedisit | 2026,2027,2028 |

4. Plani i investimeve

Ndërtimi i shkollave të reja për përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

Ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore përmes ndërtimit të shkollave të reja, me qëllim garantimin e kushteve bashkëkohore për një proces mësimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.

*Ne mije leke*

| Periudha | Titulli i veprimtarise | Vlera e plote e projektit | Vitet | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 | Buxheti 2028 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2024 | Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare "Beselidhja e Malesise" | 82,500,000 | 2024,2025,2026 | | | |
| 2024 | Supervizim punimesh i shkolles 9-vjecare "Beselidhja e Malesise" | 916,266 | 2026,2027,2028 | | | |
| 2025 | Supervizim punimesh Rikonstruksioni i Kopshtit nr.2 "Fatime Sokoli" | | 2025-2027,2028 | | | |
| 2025 | Supervizim punimesh Rikonstruksioni I Kopshtit nr.1 "Rreze Drite" | | 2025-2027,2028 | | | |
| 2025 | Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare "Lek Qokaj" | | 2025-2027,2028 | | | |

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

**1. Monitorimi i realizimit të aktiviteteve**

